

V E N D I M
Nr.473, datë 3.10.1994

**PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË FUNERALIT,
MIRËMBAJTJES SË SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA, DEKORIT DHE VARREZAVE
PUBLIKE E TË DËSHMORËVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Organet e pushtetit lokal, me fondet buxhetore të caktuara, të bëjnë prokurimin e shërbimeve të funeralit, gjelbërimit, dekorit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike e të dëshmorëve.

Prokurimi do të kryhet për ndërmarrjet e sektorit ekzistues nëpërmjet kontratave të sipërmarrjes me specialistë të njësisë të shërbimit ose shoqëri të vendit a të huaja.

2. Procedurat e dhënies në sipërmarrje të këtyre shërbimeve të jenë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993 "Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore", me afate kohore deri në 5 vjet.

3. Organet e pushtetit lokal të caktojnë territoret ku do të kryhet shërbimi dhe të organizojnë gara të veçanta për sipërmarrjen e shërbimeve në këto territore.

4. Duke u bazuar në grupimin e rretheve të bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.8, datë 17.1.1994, rrethet e kategorisë III e IV që veprimtaritë i kanë në sektorë të një ndërmarrjeje, të organizohet një sipërmarrje për të gjitha veprimtaritë.

5. Kontratat për shërbimet e caktuara në pikën 1 do të përcaktojnë standardet e kryerjes së shërbimeve, kohën e kryerjes, frekuencat e punimeve, cilësinë e tyre e sanksionet për mosrealizimin e kushteve të kontratës.

6. Kontratat e para për shërbimet publike do të lidhen pas miratimit nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

7. Organet e pushtetit lokal të caktojnë një kontrollor të zbatimit të kontratës, i cili do të paguhet nga buxheti i caktuar për këto shërbime.

Kontrollori do të hartojë raporte mujore për mangësitë dhe sanksionet që propozohen, të cilat ia paraqet këshillit bashkiak.

8. Parqet periferike të qyteteve, Kopshti Zoologjik, varrezat e kombit dhe parqet kombëtare përjashtohen nga ky vendim për kalim me sipërmarrje.

Këto objekte të administrohen nga shteti.

9. Kontrollori i kontratave do të përgatitë edhe një raport vjetor për Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit. Raporti do të përfshijë kopje të të gjitha kontratave të lidhura, kopje të raporteve të hartuara për këshillin bashkiak dhe bilancin e shpenzimeve të fondeve të buxhetit.

Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit përgatit një përmbledhje të raporteve dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave, së bashku me propozimet e saj për ndryshime të mundshme në procedura ose në buxhet.

10. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të përgatisë udhëzimet e nevojshme dhe kontrata tip e manuale operative për bashkitë. Ministria të ndihmojë organet e pushtetit lokal që të përdorin kontratat tip në përputhje me kushtet e tyre, si dhe të zgjidhë problemet me kontraktuesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi